

Informacione mbi vlersimin e moshes.

Në Itali bëhesh i rritur në moshën 18 vjeçare.

Me dokumentet ne pronesi mund të tregoni moshën tuaj. Dokumentet e njohura si të vlefshme, nëse janë në origjinal, janë: pasaporta, një dokument identifikimi, edhe nëse ka skaduar.

Nëse nuk aplikoni për azil, mund të kërkoni nga Konsullata ose Ambasada e vendit tuaj t'ju lëshojë pasaportën ose dëshmi tjetër të identitetit që tregon moshën tuaj. Pothuajse gjithmonë, në këto raste ata kërkojnë së paku certifikatën e lindjes.

Disa dokumente, siç është certifikata e lindjes pa fotografi, nuk janë të mjaftueshme për të vërtetuar moshën tuaj, por ato janë dokumente të rëndësishme që duhet të merren në konsideratë.

Nëse nuk keni dokumente me vete, por keni dikë në vendin tuaj që mund t'i dërgoje tek ju, është e rëndësishme ti merrni sa më shpejt që të jetë e mundur.

Nëse dokumentet tuaja nuk janë të vlefshme ose nëse nuk keni dokumente, duhet të deklaroni saktësisht emrin tuaj të plotë dhe datën e lindjes tuaj. Është shumë e rëndësishme që të thoni të vërtetën.

Nëse deklaroni një moshë tjetër përveç asaj reale dhe përdorni dokumente të rreme, duhet të dini që janë krime të rënda, të cilat mund të dënohen me burgim.

Gjithashtu, nëse ju merrni një leje qëndrimi si i mitur dhe më pas gjihet se keni qenë në moshe madhore, do t'ju terhiqet leja e qëndrimit dhe ju mund të humbni të drejtën për të qëndruar në strukturën për të miturit ku jeni pritur. Për më tepër, nëse vini nga një qendër pritjeje, bëhet e vështirë për ju që të ktheheni.

Nëse jeni i mitur do t'ju caktohet një kujdestar që do t'ju ndjekë në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me ju, për të gjitha praktikat për lejen e qëndrimit dhe dokumentet. Kujdestari është përfaqësuesi juaj ligjor.

NËSE DEKLAROHENI I MITUR, ligji italian parashikon që **ju mund të hetoheni për të përcaktuar moshën tuaj.**

Para çdo vendimi të vlerësimit, ju keni të drejtë të informoheni se çfarë do të ndodhë dhe çfarë mund të jenë rezultatet. Për të qenë i sigurt që e kuptoni tërë procedurën, keni të drejtë të ndihmoni nga një ndërmjetës gjuhësor / ndërkulturor.

Kur nuk mund ta vërtetoni moshën tuaj, Prokurori në Gjykatën për të Mitur do t'ju urdhërojë që të behen këto hetime:

a) Do të takoheni me personel të specializuar i cili do të përpiqet të kuptojë historinë tuaj (si keni ardhur në Itali, ku jeton familja juaj, nëse keni të afërm në Itali ose në Evropë me të cilën dëshironi të jetoni, cilat shkolla keni ndjekur në vendin tuaj, çfarë pune keni bërë , etj)

b) do të haseni me nje antar te forcave te rendit i cili do të marrë shenjat e gishtërinjve tuaj dhe do t'ju japë një kod identifikimi unik, i cili gjithmonë mund të konfirmojë identitetin tuaj dhe pastaj, ju do të duhet të bëni ekzaminime mjekësore dhe teste shëndetësore.

Do te behet nje radiografi të duarve tuaja dhe mund të bëhen teste të tjera (për shembull dhëmbët). Së fundi do të vizitohet nga një mjek i cili do të shkruajë një raport përfundimtar.

Rezultati i hetimeve do t'i komunikohet Prokurorise Publike të të Miturve, të cilët do të paraqesin një apel Gjyqtarit të të miturve për të ratifikuar moshën e caktuar, ndaj kujdestarit tuaj nëse është caktuar.

Nëse kujdestari nuk është ende caktuar, do t'i komunikohet pergjegjesit të objektit të pritjes. Ju keni të drejtë të kërkonit tutorin tuaj për një kopje me shkrim të rezultateve të hetimeve.

Nëse, edhe pas këtyre hetimeve, ju jeni në gjendje të merrni një dokument të dobishëm për vërtetimin e moshës tuaj, ju keni të drejtë ta paraqisni atë pranë zyres se nje gjyqtari për ta marrë atë në konsideratë.

Gjykata do të bëjë një dispozitë për të përcaktuar moshën tuaj në kohët e përcaktuara me ligj. Ju keni të drejtë të kërkonit që të dëgjohet nga gjyqtari.

Nëse nuk pajtoheni me rezultatin e hetimeve ju mund të beni apel tek një gjyqtar tjetër kundër kësaj dispozite. Afati i fundit për paraqitjen e ankesës është shumë i shkurtër: 10 ditë pasi te jeni njoftuar mbi urdhrin.

Gjatë procesit gjyqësor para gjyqtarit të të miturve dhe në rastin e ankesës kundër vendimit tuaj, ju keni të drejtë të caktoni një avokat dhe të merrni ndihmë juridike falas (dmth. Avokati paguhet nga shteti italian).

Deri në përfundimin e procedurës, ju keni të drejtë të trajtoheni si i mitur, prandaj ju duhet të pranoni pritjen pranë nje objekti për të mitur nga io cili nuk mund te deboheni.

Nënshkrimi për shikim

Personi i interesuar

Nenpunesi